**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E INDUSTRISE, TRANSPORTIT DHE TREGTISE**
**Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil**

# UDHEZIM

Nr. 34, Date 29.2.1996

## "Per dhenien e licensave ne kryerjen e aktivitetit per agjensi shitje biletash ne fushen e transportit ajror"

Ne zbatim te Ligjit Nr.7877 date 30.11.1994 "Per Aviacionin Civil", si dhe te detyrimeve si anetare te ICAO-s, per te patur nje rregull ne dhenien e lejeve per kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve te caktuara ne fushen e Aviacionit Civil si brenda dhe jashte vendit, Ministri i Industrise, Transportit dhe Tregtise,

## Udhezon

### Domosdoshmeria

Qellimi i ketij udhezimi eshte te siguroje nje udhezues i cili me vone do te pasurohet dhe do te sherbeje ne themelimin e nje sistemi Licensimi ne fushen e agjensive per shitje biletash ne transportin ajror .
Qellimi i tij eshte gjithashtu te siguroje se veprimet e licensimit jane kryer ne perputhje me Ligjin e Aviacionit Civil dhe ne uniformitet me standartet dhe procedurave Konventes se ICAO-s dhe anekseve te saj .
Nevoja per te patur nje leje ne kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve te caktuara ne fushen e aviacionit ka qene pranuar ne pergjithesi .

Kjo leje eshte dhene normalisht ne formen e nje License .
Ne kuptimin me te cilen eshte perdorur ketu ,Licensimi, eshte nje proces i dhenies se nje leje zyrtare nje personi juridik ( kompanie ) , ne kryerjen e aktiviteteve te vecanta te Aviacionit Civil .
Akti i Licensimit per rjedhoje konsiston ne garantimin e privilegjeve aplikusve te cilet kane aritur te mbushin kerkesat per marjen e saj .
Por perpara dhenies se licenses , shteti ( DPAC ) si perfaqesues i interesave publike , duhet te jete i bindur qe aplikuesi kenaq kerkesat dhe standartet , me njohurite , eksperiencen dhe efikasitetin me qellim qe te jete kompetetnt ne kryerjen e aktivitetit te autorizuar apo privilegjeve te garantuara nga Licensa .

**Neni 1**

Kerkesat per marjen e licenses per agjensi shitje biletash per transport ajror jane si me poshte .

a- Kerkesen zyrtare prane D.P.A.C .

b- Pershkrimin e zhvillimit te veprimtarive ne fushen e transportit ajror ku te paraqiten:
- objektivi dhe synimet e veprimtarise;
- çmimet dhe tarifat qe do te perdoren per çdo linje dhe kushtet lehtesuese;
- treguesit ekonomike e financiare qe parashikohen;
- kontigjenti i punonjesve, pergatitja e tyre tekniko-profesionale dhe programet e treinimit dhe kualifikimit te tyre.

c- Kontraten (aktin) e themelimit te subjektit, statutin ose rregulloren e funksionimit te tij.

ç- Dokumentet e identitetit per subjektin ekonomik te huaj, per rastet kur bashkepunohet me to, duke perfshire veprimtarine ne fushen e transportit ajror kur ushtron ne vendin e vet:

- deshmine e penalitetit nga Gjykata e vendit ku personi ka shtetesine per personat praktik te huaj dhe ato shqiptare ne bashkepunim me te huajt.
- dokumentet e identitetit te personelit te huaj duhet te jene te vertetuar nga administrata shteterore e shtetit qe e leshon dhe e noteruar ne ate shtet. Keto dokumente te jene te perkthyera ne shqip e te noteruara ne vendin tone.

d- Kredibilitetin financiar,
- vertetimin e hapjes se llogarise bankare nga banka perkatese shqiptare per fillimin e aktivitetit. [illegible]
- vertetim nga banka qe ka gjendje financiare pozitive per firmat qe kane aktivitet mbi nje vit.

e- Deklaraten per dergimin e informacionit statistikor e kontabel.

f- Mandat arketimi ose mandat-derdhje ne banke te tarifes se pageses per lejen qe kerkohet.
g- Licensen e IATA-s per kete aktivitet ( per personelin ), ose dokument trejnimi nga kompanite ajrore apo nga organet aeronautike . .

h- Plan vendosjen e zyrave .

**Neni 2**
Ne qofte se subjekti paraqet mangesi ose nuk ploteson kerkesat standarte per licensen e dhene , ndermiren masa nga D P A C per nje periudhe kohe te caktuar . Ne qofte se Agjensia ajrore nuk ploteson mangesite brenda limitit te dhene nga D P A C , e drejta per te shitur bileta per transport ajror hiqet perkohesisht ose perfundimisht .

**Neni 3**

Per kompanite e huaja qe operojne ne Republiken e Shqiperise , licensa per agjensi shitje biletash garantohet ne baze te mareveshjes ajrore me shtetin perkates .

*Shenim :*

Dokunentacioni qe do te paraqitet te jete ne origjinal ,ose kopje te vertetuara nga noteria qe jane te njejta me origjinalin dhe te perkthyera ne shqip .

**M I N I S T R I**

**SUZANA PANARITI**

Neni 3

Konc.